REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 41 Prot. Gjirokastër më, 13.01.2025

V E N D I M

Nr. 01, datë 13, 01, 2025

PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMEVE PËR DETAJIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit të përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit financiar të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkim shkencor", Senati Akademik në mbeldhjen e datës 13.01.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, e propozimeve për detajimin e buxhetit për vitin 2025.
2. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" · GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 42 Prot. Gjirokastër më, 13.01.2025

V E N D I M

Nr. 02, datë 13, 01, 2025

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT TË PATRËS NË GREQI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit me përfaqësues Christos I. Bouras, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 13.01.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe Universitetit të Patrës sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJIROKASTËR UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 43 Prot. Gjirokastër më, 13.01.2025

V E N D I M

Nr. 03, datë 13, 01, 2025

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT KARAMANOĞLU MEHMETBEY

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit me përfaqësues Mehmet Gavgali, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 13.01.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe Universitetit Karamanoğlu Mehmetbey sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – GJIROKASTER – UNIVERSITETI EQREM ÇABEJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 83 Prot. Gjirokastër më, 17.01.2025

V E N D I M

Nr. 04, datë 17, 01, 2025

PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT, NË PROGRAMIN E PËRBASHKËT ME UNIVERSITETIN E MAQEDONISË PERËNDIMORE, NË CIKILN E TRETË DOKTORATË NË EDUKIM DHE SHKENCA HUMANE PRANË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligiin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, neni 40, Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 22, e neni 23, Rregullores së Ugj-së neni 11, Urdhërit nr. 362 prot, datë 12.07.2024 i MAS, Vendimit nr. 01 prot, datë 16.01.2025 dërguar me shkresën përcjellëse nr. 05/1 prot, datë 16.01.2025, në mbledhjen e datës 17.01.2025 Senati Akademik:

VENDOSI :

1. Miratimin e kritereve të pranimit, në programin e përbashkët me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore, në cikiln e tretë Doktoratë në Edukim dhe Shkenca Humane pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër për vitin 2024-2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e kuotave të pranimit në programin e përbashkët 10 (dhjetë) pranime, referuar dosjes së aplikimit të miratuar me urdhër nr.362, datë 12.07.2024.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 84 Prot. Gjirokastër më, 17.01.2025

V E N D I M

Nr. 05, datë 17, 01, 2025

PËR
PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT SI ANËTAR I SENATIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Në zbatim të nenit 37, 38, 39, pika 4 Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster neni 18, pika 8; Regullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.34, datë 08.05.2024; Regullores së Brendshme të Senatit Akademik, Vendimit të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve "Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për anëtarë të Senatit Akademik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër nr.18, datë 22.06.2024, si dhe shkresës nr.38/1 prot, datë 14.01.2025, Senatit Akademik i mbledhur sot më datë 17.01.2025,

VENDOSI :

1. Të plotësoj vendin e mbetur vakant, **anëtar i Senatit Akademik**, nga radhët e personelit akademik, **Prof. Asoc Maria Koço Agolli**, si kandidate pasardhëse me numrin më të lartë të votave.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 85 Prot. Gjirokastër më, 17 01 .2025

V E N D I M

Nr. 06 , datë 17 , 01 , 2025

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE SHOQATËS LIBURNETIK

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit me përfaqësues Z. Kreshnik Lako Drejtor Ekzekutiv, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 17.01.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe Shoqatës Liburnetik sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" – GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 86 Prot. Gjirokastër më, 17.01.2025

V E N D I M

Nr. 07, datë 17, 01, 2025

PËR
KRIJIMIN E KOMITETIT SHKENCOR NË RANG UNIVERSITETI PËR FILLIMIN E PROCESIT TË HAPJES SË SHKOLLËS DOKTORALE PRANË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligiin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, pika 3, Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 19, pika 7, në VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Kreu V, pika 1, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.12.2024,

VENDOSI :

1. Të krijojë komitetin shkencor në rang universiteti si pjesë e procedurës për hapjen e shkollës doktorale.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 124 Prot.

Gjirokastër më, 23.01.2025

V E N D I M

Nr. 08, datë 23, 01, 2025

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT KANË APLIKUAR PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE, NË PROGRAMET E STUDIMIT QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligiin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, VKM –së 386/2022 "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studenttëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Rregullores së Ugj-së, shkresës përcjellëse nr. 1983 prot, datë 27.12.2024 të AKFAL, si dhe shkresës nr.90 prot, datë 20.01.2025 të Administratorit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.01.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin e listës së studentëve, të cilët kanë aplikuar për përfitimin e mbështetjes financiare, në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, për vitin akademik 2024-2025 sipas listës, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Universitare, për ta përcjellë zyrtarisht pranë Agjensisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, Drejtorisë së Granteve.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

REPUBLIKA ESHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 125 Prot. Gjirokastër, më 23 / 01 /2025

VENDIM

Nr. 09, datë 23 . 01 . 2025

MIRATIMI I KRITEREVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË "BACHELOR " , CIKLIT TË DYTË" TË STUDIMEVE, PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL 2 VJEÇAR DHE PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO - PEDAGOGJIKE PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027 DHE NJË NDRYSHIM NË KRITERET E PRANIMIT TË CIKLIT TË DYTË PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Në zbatim të Ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 38 pika 1/a dhe pika 3, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 76 pika 1 , neni 135 , Statutit të Universitetit " Eqrem Çabej ", nenit 19 pika 3 / j, referuar niveleve 5- 6- 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe propozimeve të Njësive Kryesore të universitetit "Eqrem Çabej ", si dhe mbështetur në shkresën e MAS nr. 7955/1 prot, datë 19.12.2024 "Për publikimin e kritereve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2025-2026 dhe 2026-2027" ; Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej , në mbledhjen e tij të datës, 23. 01. 2025, :

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit për studentët në programet e ciklit të parë "Bachelor", për vitin akademik 2026 – 2027, si mëposhtë:
   a. Nota mesatare e përgjithshme arithmetike e shkollës së mesme për të gjitha vitet përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore në masën 50 %.

b. Nota mesatare e gruplëndëve bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga njësitë kryesore (fakultetet) për çdo program studimi të ciklit të parë në masën 50 % (sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.)

2. Të miratojë kriteret e pranimit për studentët në programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve, programeve me karakter profesional dhe programit të formimit të vazhduar në fushën Psiko Pedagogjike për vitin akademik 2026-2027 (sipas shtojcës 2, 3, 4) .
3. Të miratojë kriteret e pranimit të ciklit të dytë për vitin akademik 2025-2026, për një ndryshim në vendimin e Senatit Akademik nr. 08, datë 06.02.2024, për arsye të riorganizimeve që programet e ciklit të dytë pësuan për vitin akademik 2024-2025 me udhër riorganizimi nga MAS.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Zëvendës Rektori për procesin mësimor, Dekanët e njësive kryesore dhe Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe publikimin e tyre në portalin Ualbania .

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 210 Prot. Gjirokastër më, 06.02.2025

V E N D I M

Nr. 10, datë 06, 02, 2025

PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 1, neni 38, pika ç, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster neni 7, Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 " Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit e Lartë" Senatit Akademik i mbledhur sot në datë 06.02.2025 me propozim të Rektorit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër,

VENDOSI :

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme të Universitetit "Eqrem Çabej" dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – GJIROKASTËR – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 211 Prot. Gjirokastër më, 06.02.2025

V E N D I M

Nr. 11, datë 06, 02, 2025

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2024, MIRATIMIN E BUXHETIT TË DETAJUAR, AKORDUAR NGA SHTETI PËR VITIN 2025, DHE REGJISTRIN E PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 3, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, Vendimit nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", neni 19, pika 2, Udhëzimit të përbashkët nr. 20, datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit financiar të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkim shkencor", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 19, pika 2, dhe shkresave të administratorit nr.197, datë 05.02.2024, nr.198, datë 05.02.2024 Senati Akademik mori në analizë draftin e paraqitur për detajimin e buxhetit të akorduar nga shteti për vitin 2025 dhe në mbeldhjen e datës 06.02.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, e raportit vjetor, përfundimtar të buxhetit për vitin 2024.
2. Miratimin, e buxhetit të detajuar, akorduar nga shteti për vitin 2025, dhe regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2025.
3. Ndryshimi i pagave do të hyjë në fuqi dhe do të zbatohet për të gjithë stafin akademik, duke filluar nga data 1 e muajit janar, në përputhje me buxhetin e ri të miratuar.
4. Një kopje e këtij vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 212 Prot. Gjirokastër më, 06.02.2025

V E N D I M

Nr. 12, datë 06, 02, 2025

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT DAUGAVPILS (REPUBLIKA E LETONISË)

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit me përfaqësues Arvīds Barševskis, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 06.02.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe Universitetit Daugavpils sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 368 Prot.

Gjirokastër më, 04.03.2025

V E N D I M

Nr. 13, datë 04, 03, 2025

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 33, pika 2, neni 49, pika gj, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster neni 18, në mbledhjen e datës 04.03.2025,

VENDOSI :

1. Të miratojë ndryshimet në Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 369 Prot.

Gjirokastër më, 04.03.2025

V E N D I M

Nr. 14, datë 04.03.2025

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 33, pika 3, neni 38, pika 1, germa d, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, në mbledhjen e datës 04.03.2025,

VENDOSI :

1. Të miratojë ndryshimet në Rregulloren e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA ESHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

SENATI AKADEMIK

Nr 370 Prot. Gjirokastër, më .04 / 03 /2025

VENDIM

Nr. 15 , datë 04 .03 . 2025

MIRATIMI I FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË CIKLIN E DYTË MASTER PROFESIONAL NË "MËSUES NË ARSIMIN SPECIAL"

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 91 , *udhëzimit nr. 14, datë 21.06.2022* "Për përcaktimin e elementëve përbërës të diplomës ose çertifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar, *udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020* ,"Për përcaktimin e elementëve përbërës të diplomës ose çertifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" Kreu II dhe Kreu III, pika 2, *udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2025* për " Disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës se regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor " dhe në zbatim të *urdhërit të MAS nr. 526, datë 09.08.2022* për "Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga Master Profesional në Mësues Ndihmës në Edukimin Gjithëpërfshirës në Master Profesional në Mësues në Arsimin Special, pika 4, Universitetit "Eqrem Çabej, *pasi shqyrtoi dhe diskutoi formatin dhe përmbajtjen e diplomës për këtë program studimi,* në mbledhjen e tij të datës, 04. 03. 2025;

V E N D O S I :

1. Të miratojë formën dhe përmbajtjen e diplomës për programin e studimit në ciklin e dytë Master Profesional në "Mësues në Arsimin Special" me 120 ECTS.
2. Formati i diplomës i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 502 Prot.

Gjirokastër më, 21.03.2025

V E N D I M

Nr. 16, datë 21, 03, 2025

PËR
KRIJIMIN E KOMITETIT KORDINUES TË PËRBASHKËT PËR SHKOLLËN DOKTRALE

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 77, neni 79, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster neni 63, Rregulloren për shkollën e doktoraturës, në mbledhjen e datës 21.03.2025,

VENDOSI :

1. Të krijojë komitetit kordinues të përbashkët për shollën doktorale pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO GANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 503 Prot.

Gjirokastër më, 21.03.2025

V E N D I M

Nr. 17, datë 21, 03, 2025

PËR
MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË "BACHELOR", CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL 2-VJEÇAR DHE PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO – PEDAGOGJIKE PËR VITIN AKADEMIK 2025 - 2026

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 69, pika 3, Statutit të UGJ-së, neni 62 pika 4, referuar niveleve 5-6-7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve neni 81, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe çertifikohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbështetur në Vendimin nr. 4, datë 19.03.2025 "Për miratimin e kuotave të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore", Vendimit nr. 03, datë 20.03.2025 të Fakultetit Ekonomik dhe Vendimit nr. 03, date 19.03.2025, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës; shkresës përcjellëse të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit nr. 499 prot, datë 21.03.2025 në mbledhjen e Senatit Akademik të datës 21.03.2025,

VENDOSI :

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve për vitin akademik 2025 -2026, për programet e ciklit të parë, ciklit të dytë, cikit të tretë të studimeve, programeve me karakter profesional 2 - vjeçar dhe programit të formimit të vazhduar në fushën psiko - pedagogjike sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen për miratimin e këtij vendimi Bordi i Administrimit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI
PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 737 Prot.

Gjirokastër më, 28.04.2025

V E N D I M

Nr. 18, datë 28.04.2025

PËR

MIRATIMIN E AMENDIMEVE NË RREGULLOREN E STUDIMEVE TË DOKTORATURËS

Senati Akademik i Universitetit Universitetit "Eqrem Çabej", i mbledhur në seancën e tij të rregullt në datën 28.04.2025, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i Asociuar' dhe 'Profesor'", i ndryshuar; të akteve nënligjore në fuqi, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; Duke marrë në konsideratë propozimin e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore;

VENDOSI:

1. Të miratohen amendimet në Rregulloren "Për organizimin e programit të përbashkët të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës në "Edukimi dhe Shkencat Humane", sipas versionit të paraqitur bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Amendimet hyjnë në fuqi nga data e miratimit të këtij vendimi dhe zbatohen për të gjithë kandidatët në ciklin e tretë të studimeve.
3. Ngarkohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore si struktura përgjegjëse për procesin e doktoraturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – GJIROKASTËR – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 738 Prot.

Gjirokastër më, 28.04.2025

V E N D I M

Nr. 19, datë 28, 04, 2025

PËR

MIRATIMIN E PIKAVE TË DOKUMNETIT PËR ARSIMIN E LARTË 2030

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", i mbledhur në seancën e rregullt në datën 28.04.2025, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenin 38, pika 1, gërma b, nenin 39, pika 6 dhe neni 40, pika 3 që rregullojnë kompetencat e organeve drejtuese dhe miratimin e dokumenteve strategjike institucionale, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej", neni 19, pika 2, gërma a, që përcakton kompetencat e Senatit Akademik për miratimin e strategjive zhvillimore të institucionit, Rregulloren e brendshme të Universitetit, Shkresën e paraqitur në rektorat me nr. 403 prot, datë 10.03.2025 "Informacion mbi çështjet e diskutuara në takimin e organizuar për prezantimin e dokumentitt për Arsimin e Lartë" , duke marrë në konsideratë rëndësinë që ka dokumenti strategjik si një mjet planifikimi për zhvillimin e qëndrueshëm të universitetit në përputhje me politikat e MAS;

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së dokumentit "Informacion mbi çështjet e diskutuara në takimin e organizuar për prezantimin e dokumentitt për Arsimin e Lartë" dhe pas diskutimeve të zhvilluara në mbledhjen e Senatit Akademik, me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë dokumenti "Informacion mbi çështjet e diskutuara në takimin e organizuar për prezantimin e dokumentitt për Arsimin e Lartë", i cili përbën bazën orientuese për zhvillimin institucional në fushat e: mësimdhënies dhe programeve të studimit, kërkimit shkencor dhe inovacionit, bashkëpunimit ndërkombëtar, zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe menaxhimit institucional.
2. Ngarkohen Rektorati, njësitë kryesore dhe nëndegët akademike, si dhe administrata, të rrisin vigjilencën dhe të jenë në gadishmëri të plotë, në mënyrë që, sapo të miratohet dhe të dërgohet plani i detajuar i veprimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të nisin menjëherë procedurat për zbatimin e tij duke hartuar planin tonë strategjik të veprimit 2030.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Dokumenti "Informacion mbi çështjet e diskutuara në takimin e organizuar për prezantimin e dokumentitt për Arsimin e Lartë", i bashkëlidhet këtij vendimi dhe botohet në faqen zyrtare të universitetit.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 769 Prot. Gjirokastër më, 06.05.2025

V E N D I M

Nr. 20, datë 06, 05, 2025

PËR
AKORDIMIN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" PËR PROF. ELENI GRIVAS NGA UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, pika 3, Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 19, pika 9, në VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Kreu V, pika 1, me propozimin e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me shkresën Nr. 1933 Prot., datë 13.12.2024, dhe me pëlqimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shkresa me Nr. 7542 Prot., datë 03.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.05.2025,

VENDOSI :

2. T'i akordojë titullin "Doctor Honoris Causa" për Prof. Eleni Grivas, me motivacionin:

Personalitet akademik me dimesione ndërkombëtare në fushën e dygjuhësisë dhe në promovimin dhe implementimin e një vizioni akademik modern të edukimit multikulturor dhe të dialogut ndërkulturor. Zonja Griva u obligua me prioritet në konsolidimin e këtyre vlerave në Universitetin "E.Çabej" të Gjirokastrës dhe kontribuoi në ndërkombëtarizimin e institucionit tonë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - GJIROKASTËR - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 770 Prot. Gjirokastër më, 06.05.2025

V E N D I M

Nr. 21, datë 06, 05, 2025

PËR
AKORDIMIN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA" PËR PROF. THEODHOROS THEODHULIDHIS NGA UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, pika 3, Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 19, pika 9, në VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Kreu V, pika 1, me propozimin e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me shkresën Nr. 1932 Prot., datë 13.12.2024, dhe me pëlqimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shkresa me Nr.7542 Prot., datë 03.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.05.2025,

VENDOSI :

1. T'i akordojë titullin "Doctor Honoris Causa" për Prof. Theodhoros Theodhulidhis me motivacionin:

Personalitet me prestigj akademik ndërkombëtar, me arritje të rëndësishme shkencore dhe akademike në fushat e Elektroteknikes (ose Inxhinierisë Elektrike) dhe të Fushave Elektromagnetike në sisteme energjetike. Zoti Theodoulidis luajti rolin primar në bashkëpunimin me Universitetin "E. Çabej" të Gjirokastrës, duke kontribuar në konsolodimin e identitetit të tij universitar.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

K R Y E T A R I
PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 771 Prot.

Gjirokastër më, 06.05.2025

V E N D I M

Nr. 22, datë 06.05.2025

PËR

SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË ÇERTIFIKATËS SË NJOHJES SË GJUHËS ANGLEZE PËR APLIKANTËT NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATURË" NË EDUKIM DHE SHKENCA HUMANE, STAF AKADEMIK TË ANGAZHUAR ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Senati Akademik i Universitetit Universitetit "Eqrem Çabej", i mbledhur në seancën e tij të rregullt në datën 06.05.2025, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 79, pika 2, neni 80, pika 4, Udhëzimin nr.10, datë 16.06.2023 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", i ndyshuar"", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 69 dhe 70, Rregullores së Ugj-së, neni 82, pika 1, Rregullores "Për organizimin e programit të përbashkët të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës në "Edukimi dhe Shkencat Humane", neni 20, pika 3/d, si dhe mbështetur në kërkesën me shkrim të aplikantëve, si personel akademik me kohë të plotë pranë Ugj-së;

V E N D O S I :

1. Afati për dorëzimin e çertifikatës së njohjes së gjuhës së huaj angleze të nivelit B2 përcaktimeve në aktet e mësipërme ligjore, do të jetë deri në 1 (një) vit nga shpallaja e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore si struktura përgjegjëse për organizimin dhe drejtimi e këtij programi, për njoftimin e aplikantit si personel akademik me kohë të plotë pranë Ugj-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, punlikohet në faqen zyrtare të institucionit dhe i bashkëlidhet dokumentacionit përkatës të çdo kandidati të përfshirë.

KRYETARI
PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 865 Prot. Gjirokastër më, 27.05.2025

V E N D I M

Nr. 23, datë 27, 05, 2025

PËR

RIORGANIZIMIN E PJESSHMË TË PLANEVE MËSIMORE DHE KURRIKULËS SË TYRË PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 DER NË MASËN 20 % TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar neni 38, gërma f, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 19, pika 3, gërma i, Rregullores së Brendshme të Universitetit, neni36, pika 4, Vkm-së nr.185, datë 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në venimin nr.41, datë 18.12.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" mbështetur më rekomanimin e grupit të lerësimit të jashtëm, të shprehur në raportin e vlerësimit të jashtëm, inciuar me shkresën e rektorit nr.589/1 prot, datë 07.04.2025 "kërkesë për riorganizim të pjeshshmëm të planeve mësimore dhe kurrikulës së tyre për vitin akademik 2025-2026, deri në masën 20%", si dhe pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga njësitë kryesore dhe të analizuara,

VENDOSI:

1. **Të miratohet riorganizimi i pjesshëm të planeve mësimore** dhe kurrikulës së tyre për vitin akademik 2025-2026 në masën 20 % në programet e studimit universitare (bachelor, master), sipas strukturës së paraqitur nga Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore me Vendimin nr.06, datë 06.05.2025 protokolluar me nr.93, datë 06.05.2025.
2. **Të miratohet riorganizimi i pjesshëm të planeve mësimore** dhe kurrikulës së tyre për vitin akademik 2025-2026 në masën 20 % në programet e studimit universitare (bachelor, master), sipas strukturës së paraqitur nga Fakulteti Ekonomik me Vendimin nr.04, datë 30.04.2025 protokolluar me nr.42, datë 30.04.2025.
3. **Të miratohet riorganizimi i pjesshëm të planeve mësimore** dhe kurrikulës së tyre për vitin akademik 2025-2026 në masën 20 % në programet e studimit universitare (bachelor, master), sipas strukturës së paraqitur nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me Vendimin nr.04, datë 27.05.2025 protokolluar me nr.59, datë 27.05.2025.

4. Zbatimi i këtij vendimi do të filojë me hyrjen në fuqi të vitit akademik 2025–2026.

5. Ngarkohen, Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi në përputhje me afatet dhe udhëzimet ligjore në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 866 Prot. Gjirokastër më, 27.05.2025

V E N D I M

Nr. 24, datë 27.05.2025

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT "DEMOCRITUS" TË TRAKËS NË GREQI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.05.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe "Democritus" të Trakës në Greqi sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" · GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 867 Prot.

Gjirokastër më, 17.05.2025

V E N D I M

Nr. 25, datë 17, 05, 2025

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT NDËRKOMBËTARË NË STRUGË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.05.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe Universitetit Ndërkombëtar në Strugë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – GJIROKASTËR – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 868 Prot. Gjirokastër më, 27.05.2025

V E N D I M

Nr. 26, datë 27.05.2025

PËR
MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMI NDËRMJET UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTER DHE UNIVERSITETIT LINGAYA'S VIDYAPEETH, FARIDABAD, HARYANA, INDIA

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 4, gërma c, neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokaster, neni 19, pika 3, gërma e, si dhe referuar marrëveshjes së bashkëpunimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.05.2025,

VENDOSI :

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së mirëkuptimit, ndërmjet Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokaster dhe **Universitetit Lingaya's Vidyapeeth, Faridabad, Haryana, India** sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 869 Prot.

Gjirokastër më, 27.05.2025

V E N D I M

Nr. 27, datë 27, 05, 2025

PËR

PËRCAKTIMIN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË PERSONELIT AKADEMIK NË POZICIONIN "DOCENT" ME GRADË SHKENCORE DOKTOR (DOC. DR.)

Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, i mbledhur më datë, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 37, neni 38, pika 1, gërma k; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" neni 19, Rregulloren e Brendshme të Universitetit, Kërkesën e paraqitur nga Doc. Dr Etleva Peta si dhe duke parë nevojën për garantimin e një trajtimi të drejtë financiar për personelin akademik që zotëron titullin "Docent" dhe gradën shkencore "Doktor" (Doc. Dr.), në përputhje me nivelin e përgjegjësisë dhe kontributit akademik,

VENDOSI:

1. Personeli akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", i pajisur me titullin "Docent" dhe gradën shkencore "Doktor" (Doc. Dr.), i cili është i punësuar me kohë të plotë në institucion, do të trajtohet financiarisht në nivelin e pagës mujore të Profesorit të Asociuar.
2. Ky Vendim njeh trajtimin financiar të barabartë për personelin me titull "Docent" dhe gradë "Doktor" pavarësisht pozicionit formal "Lektor", duke respektuar statusin dhe përgjegjësitë reale akademike në përputhje me ligjin dhe rregulloret e institucionit.
3. Vendimi të dërgohet në Bordin e Administrimit për miratim.
4. Ngarkohen Rektorati, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe njësitë akademike përkatëse për zbatimin e këtij vendimi dhe reflektimin e tij në dokumentacionin zyrtar dhe në strukturën buxhetore të institucionit.
5. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Universitetit dhe i komunikohet të gjitha njësive për zbatim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të ketë efekt financiar që nga data 01.06. 2025.

KRYETARI

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 870 Prot. Gjirokastër më, 27.05.2025

V E N D I M

Nr. 28, datë 27, 05, 2025

PËR

DHËNIEN E TITULLIT "PROFESOR EMERITUS" Z. NIKO ROGO

Në mbështetje të:Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; neni 38, gërma k, neni 61, pika 5, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, neni 50 pika 6, Rregullores së Brendshme të Institucionit neni 87, pika 2, 3, 4, 5; Vendimit të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore nr. 07, datë 16.05.2025, në mbështetje të kontributit të spikatur akademik dhe shkencor; Senati Akademik, në mbledhjen e dates 27.05.2025 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe në vlerësim të karrierës së shquar akademike dhe shkencore të z. Niko Rogo,

V E N D O S I:

1. Ti akordohet titulli akademik **"Profesor Emeritus"** z. Niko Rogo në vlerësim të kontributit të dalluar shumëvjeçar në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit institucional në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet subjektit të interesuar.

K R Y E T A R I

PROF. DR JAHO CANA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" – GJIROKASTËR